

Në pajtim me nenin 55 paragrafi 1 i Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare" Gazeta e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 161/2019), Ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi plan-program të shkurtuar për lëndën Arsimi figurativ për klasën V të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/21.

PROGRAM I SHKURTUAR MËSIMOR


# ARSIMI FIGURATIV

Gusht 2020

**Klasa V**

ARSIMI FILLOR

NËNTËVJEÇAR



MINISTRIA PËR ARSIM DHE SHKENCË  
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

## 1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën **Arsim figurativ** bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura të parashikuara me programin mësimor për lëndën që zbatohet rregullisht në përputhje me plan-programin e përcaktuar.

Me programin e shkurtuar për vitin shkollor 2020/2021, përcaktohen tema të caktuara/fusha mësimore dhe njësi mësimore që duhet të realizohen gjatë 159 ditëve mësimore, me kohëzgjatje prej 30 minutash, me çka ruhet fondi i parashikuar javor i orëve të përcaktuara në programin e rregullt, 2 orë në javë, respektivisht, 64 orë gjithsej.

Arsimtari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, konceptet, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në plan-programin e rregullt mësimor për lëndën e Arsimit figurativ.

## 2. Vështrim i temave dhe njësive mësimore

TEMA: VIZATIMI (11 ORË)
Njësitë mësimore: <ol style="list-style-type: none"><li>1. Mjetet e vizatimit dhe përdorimi i tyre</li><li>2. Elementet e artit figurativ në vizatim</li><li>3. Llojet e ritmit në vizatim</li><li>4. Vizatimi i vijës (vija e konturës)</li><li>5. Vizatimi i vijës (vija të ndryshme)</li><li>6. Vizatimi i vijës (statike dhe dinamike)</li><li>7. Vizatimi i formës</li><li>8. Vizatimi i teksturës</li></ol>

9. Vizatimi i teksturës - tush dhe pendë
10. Vizatimi i hapësirës (objekte afër dhe larg)
11. Vizatimi i hapësirës (objektet që lëvizin dhe nuk lëvizin) - statika dhe dinamika

#### TEMA: PIKTURIMI (28 ORË)

Njësitë mësimore:

1. Mjetet themelore për pikturimin dhe përdorimi i tyre
2. Pikturimi - Ngjyra - (ngjyrat kromatike)
3. Pikturimi - Ngjyra kromatike - motivi - "Ndërtime nga e kaluara"
4. Pikturimi - Ngjyra - (ngjyra të ngrohta)
5. Pikturimi - Ngjyra - ngjyra të ngrohta - tempera
6. Pikturimi - Ngjyra - (ngjyra të ftohta)
7. Pikturimi - Ngjyra - ngjyra të ftohta - gouache (guash)
8. Pikturimi - Ngjyra - (ngjyra të ndritshme dhe të errëta)
9. Pikturimi - Ngjyra - (ngjyra të ndritshme dhe të errëta) - Ritëm i lirë - tempera
10. Pikturimi - Ngjyra - (ngjyrat akromatike)
11. Pikturimi - Ngjyra - ngjyra akromatike - tempera
12. Pikturimi - Shkallëzimi i tonit (ngjyra, toni, drejtimi dhe struktura)
13. Pikturimi - Shkallëzimi i tonit (ngjyra, toni, drejtimi dhe struktura) - kompozim i lirë - gouache
14. Pikturimi - Ngjyra (kontrasti plotësues/komplementar)
15. Pikturimi - Ngjyra (kontrasti plotësues/komplementar) - motivi - lara popullore (ikuq-jeshil) - (tempera)
16. Pikturimi - Ritmi i formave
17. Pikturimi - Ritmi i formave - tempera
18. Pikturimi - me ngjyra (ngjyra plotësuese)
19. Pikturimi - i natyrës (jetës) së vdekur
20. Pikturimi - i sipërfaqes, teksturës
21. Pikturimi - i sipërfaqes, teksturës - motivi - teksturë natyrore - (tush)

22. Pikturimi - sipas përvojës dhe fantazisë
23. Pikturimi - Ngjyra (ngjyrat kryesore dhe dytësore) - motivi - Ekologji (pikturë nga vëzhgimi)
24. Pikturimi - Ngjyra (kontrasti plotësues - kolazh) - forma abstrakte 2D (portokalli - blu) – kompozicion abstrakt
25. Pikturimi - i hapësirës së brendshme dhe të jashtme
26. Pikturimi - i hapësirës së brendshme dhe të jashtme
27. Pikturimi - kombinim i formave të vogla dhe të mëdha me teksturë figurative
28. Pikturimi - kombinim i formave të vogla dhe të mëdha me teksturë figurative

#### TEMA: FORMËSIMI NË HAPËSIRË, MODELIMI (11 ORË)

Njësitë mësimore:

1. Mjetet e modelimit
2. Ndërtimi, formësimi
3. Formësimi, modelimi - vëllimi (kontrasti i vëllimit)
4. Formësimi, modelimi - vëllimi (kontrasti i vëllimit) - (argjila)
5. Formësimi i hapësirës, modelimi, ndërtimi - kontrasti i madhësive dhe formave
6. Formësimi i hapësirës, modelimi, ndërtimi - kontrasti i madhësive dhe formave - paketimi
7. Formësimi i hapësirës, modelimi - proporcioni
8. Formësimi i hapësirës, modelimi - Proporcioni - (argjila)
9. Vlerësimi estetik
10. Modelimi dhe ndërtimi sipas vëzhgimit, kujtesës dhe fantazisë
11. Modelimi dhe ndërtimi sipas vëzhgimit, kujtesës dhe fantazisë - vlerësim

#### TEMA: DIZAJNI DHE KOMUNIKIMET (7 ORË)

Njësitë mësimore:

1. Elementet e artit në dizajn

2. Dizajn – dekorimi i sendeve
3. Dizajn - motivi: Dekorime të Vitit të Ri
4. Dizajn – hartim/skicim i sendeve dekorative
5. Dizajn – krijim i sendeve dekorative - motivi – karakter (personazh)
6. Komunikimet vizuale dhe dizajni - vizatimi
7. Komunikimet vizuale dhe dizajni - skicimi
8. Komunikimet vizuale dhe dizajni - skicimi i një situatë trafiku

#### TEMA: GRAFIKA ( 7 ORË )

Njësitë mësimore:

1. Grafika – Hapësira, sipërfaqja
2. Grafika - Hapësira, sipërfaqja - motivi - Natyra e vdekur (laps)
3. Grafika - Kontrasti (i vogël - i madh)
4. Grafika - Kontrasti (i vogël -i madh) - (karton)
5. Grafika – Printimi i monotipit
6. Grafika - Format, madhësitë dhe ngjyrat
7. Grafika - Format, madhësitë dhe ngjyrat (print) motivi - lulet

### 3. Rekomandimet didaktike

Pikënisja për realizimin e programit mësimor të shkurtuar për lëndën e arsimit figurativ është programi mësimor i rregullt (qëllimet specifike, konceptet, aktivitetet dhe metodat e propozuara). Realizimi efektiv i njësive mësimore në këtë program, veçanërisht për formimin e koncepteve nga ana e nxënësve, varet shumë nga zbatimi i qasjes së integruar. Kjo do të thotë që gjatë planifikimit të orëve ditore të arsimit figurativ, mundësitë për lidhje të integruar me lëndët tjera përdoren në maksimum: gjuhë amtare, matematikë, gjuhë angleze, njohja e mjedisit, arsimit muzikor dhe arsimit fizik dhe shëndetësor. Duke filluar nga objektivat e të mësuarit, kurdoherë që është e mundur, në procesin e të nxënësve duhet t'u sigurohet një zgjedhje e aktiviteteve dhe përmbajtjeve të ndryshme në përputhje me aftësitë, mundësitë dhe interesat e tyre. Metodatat më efektive të të mësuarit në arsimin figurativ janë ato metoda që i vendosin nxënësit në një pozicion aktiv adekuat në procesin e përvetësimit të njohurive dhe aftësive. Është e nevojshme që mësuesi të krijojë situata të të nxënësve në të cilat do të dalin në pah aktivitete të ndryshme që mundësojnë mënyra të ndryshme të të mësuarit, përdorimin e mjeteve, materialeve dhe burimeve të ndryshme të të nxënësve.

Rekomandohet që njësi të caktuara mësimore, në varësi të qëllimeve të deklaruara, të punohen në disa orë duke aplikuar ushtrime të përshtatshme për motive të caktuara. Arsimtarit i mbetet, varësisht nga mbështetja materialo-teknike që ka si dhe mundësitë dhe aftësitë e nxënësve, motivimi i tyre për krijimtari artistike, bashkëpunimi kolektiv etj., të përcaktojë kornizën kohore për realizimin e përmbajtjeve të caktuara mësimore, në përputhje me periudhën kohore të parashikuar.

### 4. Normativi për kuadrin arsimor

Programin mësimor të shkurtuar e realizon arsimtari në pajtim me normativin për kuadrin arsimor të dhënë në plan-programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën e Arsimit figurativ për klasën e pestë të shkollimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021 e konfirmoi:

Ministri për arsim dhe shkencë

---

Mila Carovska